



Ulvi Fejzullahu

Gjatë ditës nuk pata kohë të shfletoja lajmet ditore, por dikur pas namazit të jaciesë fillova të shohë se çka ka bërë vaki! Kur pa prit e pa kujtuar u ndesha me “zërin” (<http://www.zeri.info/artikulli/17856/hoxhallare-para-historik-video>) me një titull vërtetë parahistorik: “Hoxhallarë para-historik”. Me vete thashë, hajmedet çka pas ka “shkretu” Enis Rama.

Lexova shkrimin e gazetarit, pastaj, dëgjova nga kureshtja videon në fjalë. Aty për aty thashë qenka e kundërta, pasmi të bëjmë me gazetarë para-historik.

Të nderuar imanli!

Unë kam vendosur që “Zërit” tua dërgoj një mirënjohje dhe falënderim special.(Ju lutem mos më paragjykoni, këtë njëmend e kamë.) Kësaj gazete dhe gazetarëve të sajë, ja vlen një përsëritje për mënyrën që kanë zgjedhur për ta fyer Islamin dhe myslimanët duke i etiketuar hoxhallarët. Ata më këso veprimesh, vërtetë po i shërbejnë Islamit.

Unë, personalisht nuk pres prej këtyre që të ndajnë një hapësirë për temat Islame. Ata këtë nuk e bëjnë dhe nuk lejojnë. Por, mjafton që të kundërtën që po e bëjnë. Padyshim që edhe kjo është e shëndetshme. Këto sjellje dhe veprime të gazetarëve po ndikojnë duke tërhequr vëmendjen edhe të atyre që nuk janë të njohur me Islamin.

Padyshim që kemi njerëz racional dhe më nuk po dëshirojnë të jetojnë në ndikimin e gazetave dhe gazetarëve para-historike. Në momentin kur po njihen me të vërtetën, po e përqafojnë.

Kush e ka bërë mend, që gazetat me shkrime antislame janë se bënë për t'u shtrirë e vërteta Islame edhe tek xhematet e saja.

Për këtë duhet falënderuar Allahun e Lartësuar. Dhe mirënjohje të veçantë për “zërin”.

Ju lutem, herë pas here vazhdoni të bëni këso veprime, se janë të shëndetshme, edhe pse ju e mendoni të kundërtën.